



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 20 tetor 2015, në mbledhjen e XXII-të (njëzetedy) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Afrim Shabani, i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin, z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht i përshëndetë të pranishmit dhe shtoi, e hapi këtë mbledhje duke konsideruar se rendi i propozuar i ditës dhe materiali përkatës u është dërguar me kohë, nëse ndokush nga këshilltarët dëshiron të merr fjalën rreth rendit të propozuar të ditës dhe konstatimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, urdhëroni.

z.Haki Rudari, theksoi, në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar një informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe e përshëndesim këtë informatë që na është sjellë, mirëpo kam kërkuar edhe një informatë nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë rreth gjendjes së pronës publike në Komunën e Podujevës, gjendje për të cilën ne kemi lexuar në mjete të ndryshme të informimit, prandaj konsideroj se është shumë e arsyeshme për ne këshilltarët e Kuvendit ta kemi sot një informatë të tillë, nëse jo për sot, kërkoj të jetë në mbledhjen e radhës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e përsërisë se çdo kërkesë e juaja që cilësohet si e nevojshme, do të bëhet përpjekje të sjellët në Kuvend, andaj drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë është prezent këtu dhe sigurisht se dëgjoji kërkesën e parafolësit e cila besoj se do të merret parasysh dhe në një kohë sa më të shkurtër do të përgatit një informatë sepse është në interes të të gjithëve. E hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuar rendi i propozuar i ditës.

2. Propozimi i vendimit për ri-alokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2015

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera veçoi, meqë është fundi i vitit Drejtoritë përkatëse të Komunës kanë bërë një analizë të kontratave ekzistuese dhe të buxhetit në përgjithësi, andaj janë paraqitur këto propozime të cilat i keni në materiale, fjala është për ri-alokimin e mjeteve buxhetore nga kodet buxhetore apo projektet që kanë pasë tepricë të mjeteve në ato kode apo projekte që ka pasë mungesë të mjeteve buxhetore, ndërsa sqarime dhe detaje tjera të nevojshme do t'i japin drejtorët e Drejtorive përkatëse.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë propozim vendim për ri-alokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2015, dhe konsiderojmë se ky ri-alokim bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për financat e pushtetit lokal.

z.Flakron Gashi, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, fillimisht dua të ritheksoi se Ekzekutivi i Komunës nuk është duke i zbatuar vendimet e Kuvendit të Komunës, sa për t'jua rikujtuar të gjithëve, në muajin dhjetor 2014 ky Kuvend ka miratuar një vendim për planin e punës së Kuvendit dhe për muajin tetor 2015 është paraparë sjellja e raportit financiar nëntëmujor për periudhën janar-shtator 2015, pikërisht për këtë seancë dhe kjo nuk ka ndodhur, dhe kjo paraqet shkelje.

Sa i përket këtij propozim vendimi për ri-alokimin e buxhetit, qysh në hyrje vërehet se në disa projekte ka tepricë të mjeteve ndërsa ato mjete do të barten në ato projekte ku ka mungesë të mjeteve. Parimisht askush nuk e kundërshton ri-alokimin e mjeteve buxhetore, mundësi të cilën e parasheh legjislacioni i cili e rregullon çështjen e financave të pushtetit lokal, mirëpo në esencë një gjë është e papranueshme për ne Grupin e këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, dhe atë; si është e mundur që në buxhetin e Komunës për vitin 2015 në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është paraparë projekti për ndërtimin e qendrës së maternitetit faza 5A dhe janë siguruar edhe mjetet buxhetore në vlerë 200,000.00€, kurse sipas njoftimit për dhënie të kontratës me nr. të prokurimit 61515051521 vlera apo kostoja e këtij projekti është 80,328.99€, ndërsa në këtë dokument për ri-alokim janë paraqitur si tepricë e mjeteve vetëm 11,226.57€, pra këtu vërehet një diferencë prej rreth 100,000.00€ dhe shtrohet pyetja ku kanë shkuar apo ku kanë humbur ato mjete. Pastaj si është e mundur që në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit është paraparë projekti për asfaltimin e rrugëve në fshatin Bradash në vlerë prej 95,000.00€, kurse sipas njoftimit për dhënie të kontratës me nr. të prokurimit 61515107521 vlera apo kostoja e këtij projekti është 58.900.23€, pra realisht mbeten mjete buxhetore, ndërsa në këtë dokument është paraparë ri-alokim i mjeteve shitesë në shumë prej 48,368.80€, dhe shtrohet pyetja, çka do të mbulohet me këto mjete përderisa projekti i parë është mbuluar dhe madje kanë mbetur mjete buxhetore, mandej, si është e mundur që në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit është paraparë projekti, rregullimi i rrugëve me kubza në Qytet në vlerë prej 100,000.00€, ndërsa sipas njoftimit për dhënie të kontratës me nr. të prokurimit 61515104521 kostoja për realizimin e këtij projekti do të kushtoj 65,291.00€, ndërsa në këtë dokument të ri-alokimit është paraqitur si tepricë e mjeteve buxhetore shuma 19,708.84€, pra vërehet një diferencë rreth 15,000.00€ dhe shtrohet pyetja, ku janë alokuar këto mjete apo në fakt cili ka qenë parashikimi real i këtij

projekti. Në kuadër të buxhetit për vitin 2015 Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është parashikuar projekti prioritar, kolektori i ujërave të zeza Gllamnik-Kunushec në vlerë 130,000.00€, ndërsa në njoftimin për kontratë me nr. të prokurimit 61515106521 neni 3 pika 2 nënpika 3, operatorit ekonomik i kërkohet qarkullimi bankarë në vlerë prej 360,000.00€ për tri vitet e fundit, kjo është shkelje e Udhëzimit Administrativ 02/2014 dhe nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik ku specifikisht thuhet, *autoriteti kontraktues, në këtë rast Komuna, mund të kërkoj qarkullim bankar për tri vitet e fundit shumë të caktuar e cila nuk duhet të kaloj dy herë vlerën e parashikuar të projektit*, pra fjala është se vlera e projektit ka qenë e parashikuara 130,000.00€. Po ashtu kemi raste tjera ku projektet po kryhen, po shpallen kontrata njoftuese por që nuk figurojnë fare në listën e projekteve prioritare të miratuar në buxhetin e vitit 2015, fjala është për projektin e vitit 2015, adaptimi i sistemit të ngrohjes qendrore në ato me naftë dhe në ato me pelet në shkollat “Isa Boletini” dhe “Xheladin Rekalu” dhe adaptimi i sistemit të ngrohjes qendrore në ato me naftë në ato me dru dhe thëngjill në shkollat “Shefki Latifi” në fshatin Pollatë dhe në shkollën “Nuhi Gashi” në fshatin Bradash, gjithashtu askund në projektet prioritare të parapara për vitin 2015 nuk figuron projekti, ndërtimi i fushave sportive - faza 1, afër Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani” në Podujevë, andaj unë shtroj pyetje, sa është parashikuar të jetë vlera e këtyre projekteve dhe me çfarë dokumenti është bërë, megjithëse askund nuk figuron në projektbuxhetin e miratuar në vitin 2014 i cili është shëndrruar në buxhet për vitin 2015.

z.Haki Rudari, theksoi, në parim e përkrahim ri-alokimin e mjeteve buxhetore sepse është mirë që mjetet të ri-alokohen dhe të transferohen, mirëpo jemi kundër kësaj forme që po bëhet. Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje që nga fillimi i këtij mandati vazhdimisht kemi kërkuar që Drejtoritë përkatëse të kenë një plan program të detajuar në mënyrë që të mos vije deri te ri-alokimi i mjeteve, e citoj atë që në fillim të propozim vendimit thuhet, ka tepriçë të mjeteve në disa kode dhe ka mungesë të mjeteve në disa kode, andaj kjo na tregon se është një gjendje jo e mirë, ngase ka projekte të pa detajuara dhe projekte jo të menaxhuara mirë apo vetëm formalisht sa për tu mbuluar, kurse tani del që dikund ka tepriçë të mjeteve dhe dikund ka mungesë të mjeteve, konsideroj se kjo është duke u përsëritur dhe është mirë që për të mos ardhur deri kjo gjendje Drejtoritë përkatëse të bëjnë plane dhe projekte të detajuara në mënyrë që përfundimi të jetë më mirë. Sa i përket shumës e cila figuron në këtë ri-alokim, unë dua të ndalem në disa kode të cilat për ne Grupin e LVV-së janë të papranueshme, dhe atë nga projekti për Planin rregullues urban, për të cilin është diskutuar shumë, merren 34,647.00€ dhe ridestinohen në një projekt tjetër ndonëse më parë është kërkuar të ketë mjete më shumë për këtë projekt, çështja tjetër që dua të ndalem ka të bëjë me rregullimin e hapësirave publike, projekt ky nga i cili merren mjete buxhetore dhe ridestinohen në projekte tjera e që unë mendoj se nuk e kemi gjendjen e mirë në hapësirat publike për të marrë mjete nga ai projekt por përkundrazi duhet të investohet shumë më shumë në hapësirat publike, pastaj kemi ri-alokim të mjeteve nga projekti, për mirëmbajtjen e ambientit në projekte tjera, kurse realiteti është se në Qytet kemi ambient jo të mirë sa i përket mbeturinave por gjendje shumë e keqe qëndron në vendet rurale përkatësisht në fshatra të ndryshme gjë për të cilën vazhdimisht kam kërkuar dhe kam bërë pyetje Drejtorisë përkatëse, vlen të ceket se ne kemi ofruar një plan rreth menaxhimit të mbeturinave dhe kemi propozuar që shkollat të kenë kontejner mirëpo ende nuk kam vërejtur kontejner apo shporta tjera në shkolla. Në vazhdim dua të ndalem

në një çështje për të cilën nuk do të doja të merret personale, në fshatin Shajkoc prej nga vij unë, me këtë ri-alokim merren mjete në shumë 20,728.24€ dhe ridestinohen në projekte tjera, por nuk merret parasysh fakti që fshati Shajkoc ka projekte të cilat janë paguar nga ana e qytetarëve, dhe tani ato mjete ri-alokohen e që për ne është plotësisht e papranueshme, pra në njërin anë destinohen mjete për asfaltim ku projektet nuk janë të gatshme kurse në anën tjetër merren mjete nga projektet e gatshme të cilat qytetarët i kanë hartuar me mjete të tyre, andaj për këtë arsye unë vazhdimisht e përsërisë që ka të bëjë me investime politike e që për ne është tërësisht e papranueshme, unë e posedoj projektin e Lagjes Bekolli për të cilin kemi menduar se ai projekt duhet të kyçet, kurse tani përkundrazi kemi ridestinim të mjeteve të cilat merren nga fshati Shajkoc. Çështje tjetër është edhe mirëmbajtja e rrugëve, në fshatin Sfeqël ku unë punoj vazhdimisht ka rrjedhje të kanalizimit në rrugën Sfeqël-Lladoc dhe Sfeqël-Gllamnik në të cilën vazhdimisht ka qarkullim dhe nxënës që kalojnë nëpër atë rrugë, prandaj mendoj se kjo duhet pasur parasysh nga ana e Drejtorisë përkatëse, pra kemi 7,880.00€ ri-alokim për mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik por përkundrazi janë rreth 40,000.00€ që janë ndarë për këtë projekt, që për ne është plotësisht e papranueshme dhe mendoj se nuk është mirë të bëhen vetëm barazime matematikore të shumave, por është mirë që në rastet emergjente të bëhen investime, dua të them se ndahen shuma të mëdha për mirëmbajtje të kanalizimeve mirëpo gjendja e tyre nuk është aspak e mirë, po ashtu për ne është plotësisht e papranueshme ridestnimi i 35,320.00€ të parapara për furnizim me një rentgen digjital, gjë për të cilën pyes drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, a është blerë rëntgeni apo nuk ka fare nevojë të blehet, dhe pse është futur në prioritet kurse tani ato mjete ridestinohen. Çështje tjetër është edhe ndërtimi i ambulantes në fshatin Batllavë, sa unë jam në dijeni në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017 janë ndarë rreth 40,000.00€ për këtë projekt dhe i cili është ndërtuar mirëpo nuk jam në dijeni pse tani ridestinohen mjete për këtë projekt, kërkoj përgjigje nga Drejtoria përkatëse. Duke u nisur nga të gjitha këto që i ceka mendoj se ky ri-alokim bëhet vetëm sa për të mbuluar shifrat matematikore dhe për të bërë barazime, por nuk është ri-alokim në interes të qytetarëve, andaj për ne kjo është e papranueshme.

znj. Florije Maliqi, theksoi, dëshiroj të ndërlidhem me ri-alokimin e buxhetit në sektorin e shëndetësisë, meqë ne jemi në dijeni se në fshatin Batllavë ekziston një ambulantë shëndetësore, a do të ishte më mirë që ky ri-alokim të dedikohet për ndërtimin ose përfundimin e objektit të maternitetit dhe mbulimit me profesionistë adekuat kur jemi në dijeni se shumë gra shtatzëna janë të detyruara të shkojnë në QKUK-Prishtinë ku edhe ka pas raste të shpeshta që gjatë rrugëtimit deri në QKUK për shkak të urgjencës të ketë edhe humbje të jetëve të njerëzve. Pastaj është paraparë blerja e pajisjeve për raste emergjente për të cilën konsideroj se ne duhet ta dimë se cilat janë ato pajisje që do të blehen për raste emergjente.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi për ri-alokimin e buxhetit, unë do të votoj për, mirëpo përherë e kemi thënë se planifikimet nuk janë duke u bërë profesionalisht, edhe pse këtë Ekzekutivi i Komunës nuk e pranon apo nuk i ka bërë përshtypje asnjëherë. Shuma e mjeteve të cilat mbesin tepërcë për çdo vit është shumë më e madhe sesa që duhet të jetë. Çështja tjetër që dua të shtroj në formë të pyetjes, nuk jam në dijeni a ju kanë treguar juristët e Komunës që ikja prej projekteve të planifikuara dhe miratuara në Kuvend kurse investimet e projekteve të pa miratuara nga ky Kuvend, a

mund të jetë shkelje ligjore, dhe në qoftë se subjektet opozitare do të angazhonin juristët e tyre, a mund të ndodh që përfundimi do të ishte jo i mirë.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, në mbledhjen e kaluar kam shtruar pyetje drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale rreth blerjes së rentgenit digjital, kurse tani në këtë propozim vendim shohim se ato mjete ri-alokohen, andaj dëshirojmë të njoftohemi se a është blerë rentgeni digjital apo pritet të blehet, ose ndoshta është hequr dorë nga blerja e rentgenit, presë përgjigje.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, nuk dëshiroj të polemizoj me ndokënd por vetëm dua të jap disa sqarime, sa i përket këtij propozim vendimi përkatësisht ri-alokimit të mjeteve në kuadër të Drejtorisë që unë jam drejtor. Janë katër projekte të cilat ri-alokohen dhe përqindja e shumës është 6.6%, do të thotë nuk është as gjysma e shumës që kemi të drejtë të ri-alokojmë.

Shuma më e madhe e mjeteve që ri-alokohen është nga projekti për ndërtimin e garazheve dhe rregullimi i oborrit të Shërbimit të Zjarrëfikjes, kjo është bërë për arsye se Agjensioni për Menaxhimin e Emergjencave përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme ka kërkuar nga Komuna që për këtë projekt të mos zhvillohen procedura sepse është obligim i Ministrisë që të ndërton një objekt të ri për Shërbimin e Zjarrëfikjes, pra Ministria planifikon që vitin e ardhshëm të ndërton një objekt të ri për Shërbimin e Zjarrëfikjes, kështu që ne nuk kemi dashur të zhvillojmë procedura, dhe për këtë arsye ato mjete janë ri-alokuar në projekte tjera, ndërsa të gjitha ri-alokimet tjera destinohen në projekte të cilat kanë kontrata dhe në projekte të cilat ose janë në procedura të prokurimit ose në projekte që kanë mungesë të mjeteve, pra me këtë balancohen shpenzimet me borxhin eventual publik, çështje e cila është legale dhe e drejtë e çdo institucioni që të zvogëlon sa më shumë që të jetë e mundur borxhin publik, borxh mund ta kenë secila organizatë buxhetore në Kosovë sepse jemi në dijeni për rrethanat se si punohet.

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga z.Flakron Gashi rreth kolektorit të ujërave të zeza në Gllamnik-Kunushec, nuk dëshiroj të ndalem në dosjen e Departamentit të Prokurimit, mirëpo ju them se për këtë projekt nuk kanë qenë e planifikuar shuma 130,000.00€, por është planifikuar shuma rreth 300,000.00€ dhe është projekt dyvjeçar, do të thotë nga Kuvendi i Komunës është miratuar si projekt në vazhdim me shumën 130,000.00€, ndërsa në vitin e ardhshëm vazhdojnë punimet me përfundimin i projektit. Sa i përket pyetjes së z.Haki Rudarit rreth asfaltimeve tjera, ju sqaroj se ajo është kontratë kornizë dhe është në procedurë të prokurimit, është paraparë të meremetohen sipas nevojës rrugët në Qytet dhe aty ku ka mundësi në fshatra, mirëpo shuma është e limituar, kurse sa i përket prerjes së rrugëve dhe dëmtimit të tyre, është fakt që kemi probleme shumë të theksuara me Kompaninë e Ujësjellësit rreth për prerjeve të rrugëve në Qytet dhe në shumë fshatra, kompani e cila pastaj nuk i kthen rrugët në gjendjen e mëparshme, pra ndodh të ketë ndonjë rrjedhje të ujit në asfalt dhe detyrimisht bëhen prerjet e asfaltit në atë rrugë por që nuk kthehen në gjendjen e mëparshme, çështje për të cilën jemi duke biseduar me Kompaninë e Ujësjellësit në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje dhe ta rregullojmë këtë problem. Prandaj lidhur me këtë propozim vendim për ri-alokimin e buxhetit, shuma e cila ri-alokohet në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, është shumë e vogël dhe e cila kalon brenda kontratave të cilat janë në procedurë.

z.Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime dhe përgjigje sa i përket çështjeve dhe pyetjeve të ngritura në adresë të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. N'kuadër të projektit për ndërtimin e maternitetit kanë qenë të planifikuara 200,000.00€ në vitin 2014, dhe 200,000.00€ të tjera për vitin 2015, në vitin 2014 ky projekt është shpallur si projekt dyvjeçar dhe kontrata ka qenë në shumë 278,444.00€ ku 200,000.00€ janë paguar në vitin 2014 kurse pjesa tjetër prej 78,444.00€ nga ai projekt, me rishikimin e buxhetit është bartur në vitin 2015, dhe prej tyre 30,000.00€ janë destinuar për dezinfektim, derratizim dhe dezinfektim kurse pjesa tjetër e mbetur është destinuar në projektin që është plotësim kontrate në fshatin Batllavë. Sa i përket pyetjeve të z.Haki Rudari dhe z.Florije Maliqi rreth ndërtimit të objektit të ambulantes në fshatin Batllavë, ju sqaroj se kontrata për atë projekt ka qenë rreth 52,000.00€ kurse të planifikuara kanë qenë 40,000.00€, pra është ri-alokuar shuma përkatëse në mënyrë që të plotësohet kontrata përkatëse, objekti i asaj ambulante ka qenë shumë i vjetër ku vetëm një dhomë ka qenë e shfrytëzueshme ndërsa pjesë tjera të objektit nuk kanë qenë të shfrytëzueshme, kështu që është paraqitur nevoja dhe besoj se ka pas nevojë të ndërtohet objekti i ri. z.Kumrie Hoti, pyeti se a është blerë apo jo rentgeni digjital, përgjigja është, kontrata është nënshkruar dhe presim që brenda dhjetë ditëve të furnizohemi me rentgenin digjital, kurse pjesa tjetër e mjeteve është ridestinuar për blerjen e pajisjeve tjera për të cilat kushdo që dëshiron informata mund të vij në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe t'i shikon se për cilat pajisje bëhet fjalë.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk jemi kundër ndërtimit të objektit të ambulantës në fshatin Batllavë, përkundrazi i gëzohemi ndërtimit të atij objekti, mirëpo për ne është shqetësuese pse në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017 ishte shuma 40,000.00€ kurse tani me këtë ri-alokim është shtuar edhe shuma prej 12,477.10€ për atë objekt. Çështja tjetër ka të bëjë me ri-alokimin e mjeteve për mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe pusetave, ndonëse gjendja e tyre nuk është e mirë dhe për këtë unë kam informata që banorët e Lagjes Jaha në fshatin Sfeqel kanë ankesa të shumta sa i përket pusetave, andaj mendoj se në këtë drejtim duhet të punohet më shumë. Gjithashtu gjendja e rrugëve është jo e mirë, kemi rrugët Shajkoc-Sfeqel, Sekiraqë dhe Gllamnik-Lagja Kosumi ku rruga qysh tani është dëmtuar dhe në kohën e dimrit sigurisht se do të bëhet e pakalueshme, kështu që mendoj se Drejtoritë përkatëse duhet të marrin parasysh këto sikurse që duhet secila kompani që e dëmton rrugën po ajo kompani të riparoj atë, e jo të kemi raste sikurse në rrugën Shajkoc-Podujevë ku është prerë rruga nga një kompani dhe nuk është riparuar ende nga askush.

z.Flakron Gashi, theksoi, e kuptoj Kryesuesin e Kuvendit që ka presion dhe që me ngulm dëshiron vetëm ta përfundoj këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo unë nuk mora sqarim nga ai pse shkelen vendimet e këtij organi. Gjithashtu për rreth 70% të çështjeve që unë i ngrita në diskutimin e mëparshëm, nuk mora përgjigje, e që një pjesë e tyre ka të bëjë me shkelje ligjore, andaj parimisht nëse nuk keni informata ose nuk e dini se janë shkelje ligjore, nuk është marre të thuhet se nuk e dimë, por askush nuk shfaqësohet dhe nuk mund t'i ik përgjegjësisë nëse nuk e njeh ose nuk e din një rregull, apo të paktën po pajtoheni se janë shkelje ligjore dhe nuk keni çka të thoni tjetër. Unë e kuptova drejtorin parafolës z.Agron Hyseni se si ai i bëri sqarimet mirëpo një pjesë e drejtorëve tjerë ose nuk po i kuptojnë ose nuk po dëshirojnë t'i kuptojnë lojërat që janë duke u luajtur nga prokurimi, ose ndoshta jenë në dijeni për atë dhe po heshtin, kur një projekti i

parashikohet vlere ai mund të jetë si projekt i bartur nga vitet në vazhdimësi, por nëse një vlerë parashikohet për një projekt që të realizohet brenda atij viti, atëherë duhet të realizohet brenda atij viti por jo të paraqitet si shumë shabllon e gjithë kostoja se sa do të kushton për dy-tri vite me radhë. Çështja tjetër, i nderuari drejtor z.Faik Muçiqi, nëse nuk e keni pasur apo nëse nuk jeni në dijeni, Agjensioni kundër korrupsion e ka nxjerrë një opinion në lidhje me kolektorin e ujërave të zeza për gjatë Lumit Dumnica, në të cilin thuhet se procedimi i mëtutjeshëm i kësaj kontrate përbën shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik respektivisht Udhëzimit Administrativ, gjendje e njëjtë është edhe për kolektorin në Gllamnik por për atë ende nuk ka paraqitur opinion sepse ndoshta atë nuk e ngritur askush deri më tani por që do të ngritët, dhe vlere e parashikuar për vitin 2015 është 145,000.00€, ai mund të kushtoj ndoshta edhe gjysmë milioni, por për këtë vit janë parashikuar këto mjete dhe do të përfundohen aq punë për aq mjete, respektivisht kur të hapet tenderi dhe kur të bëhet njoftimi për kontratë, vlere e parashikuar për këtë vit është 130,000.00€ dhe vetë fakti që një kompanie i kërkohet mbi 350,000.00€ qarkullim bankar, kjo i bie që rreth 80% të kompanive që në start i penalizohen, dhe kjo është dukuri, prandaj po e përsërisë, drejtorët e Drejtorive ose nuk janë duke e kuptuar ose prokurimi është duke e luajtur lojën me drejtorët e Drejtorive të cilët me të dy këmbët po e shkelin, dhe këto shuma të mëdha nuk bëhen rastësisht, nëse një projekt vlerësohet dhe shuma e atij projekti, shembull, është parashikuar 100,000.00€ kurse fillohet me 50,000.00€, unë nuk e di si munden ta bëjnë një gjë të tillë zyrtarët komunal me rastin e vlerësimit të tenderëve, pra në këtë shembull shuma e parashikuar prej 100,000.00€ është për t'i hapur rrugë prokurimit për të manovruar, dhe jo rastësisht raporti i auditimit për vitin 2014 thotë se njësia e auditimit të brendshëm nuk gjen kohë të bëjë një monitorim të brendshëm të Zyrës së prokurimit.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje parafolësit, kurrfarë presioni nga askush nuk kam dhe dëshira ime është që punët e Kuvendit të Komunës të shkojnë në mënyrë demokratike dhe ashtu qysh është më së miri duke u respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe të gjitha aktet tjera të cilat ndërlidhen me këtë fushë, pastaj është e vërtetë që ne e kemi miratuar atë plan dhe unë për çdo muaj para se të përgatitet rendi i ditës konsultohem me të gjithë drejtorët e Drejtorive rreth pikave të cilat janë të parapara në plani e punës, gjithashtu në fund të vitit unë do të jap një raport rreth zbatimit të planit të punës së Kuvendit. Sa i përket raportit financiarë për periudhën janar-shtator 2015, jam konsultuar me drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili më ka thënë se ende nuk është i gatshëm por pritët që në mbledhjen e muajit nëntor ta kemi të gatshëm për Kuvend, raport për të cilin askush nuk ka interesim për t'u shmangur. Sa i përket pyetjes së z.Haki Rudarit rreth asfaltimit të rrugëve në fshatin Shajkoc, meqë unë kam qenë drejtor i Drejtorisë përkatëse në kohën kur janë asfaltuar ato rrugë, dëshiroj të jap një sqarim, asnjëherë nuk ka pasur investime politike, ashtu siç e tha këshilltari i cekur, por të gjitha kërkesat për asfaltim të rrugëve që kanë ardhur nga komuniteti i fshatit kanë hyrë në planifikime dhe janë realizuar me përjashtim të rrugës të cilën e përmendi këshilltari i cekur e cila ende nuk e ka pasur të zgjidhur çështjen e kanalizimit, por tani besoj se edhe ajo rrugë do të asfaltohet. Gjithashtu në bazë të përvojës që e kam, sa i përket ri-alokimit të buxhetit, ju sqaroj se kontrata të reja nuk mund të ketë, por janë kontrata të cilat kanë qenë të planifikuara për këtë vit dhe në ato kontrata të cilat ka tepriçë të mjeteve ri-alokohen në kontratat që ka mungesë të mjeteve buxhetore në mënyrë që të plotësohen dhe të kryhen pagesat sepse në të kundërtën përmes vendimeve të Gjykatave ato mjete

duhet t'i paguaj Komuna, po ashtu mjete që kanë tepruar nga projekte të ndryshme nëse nuk shfrytëzohen në këtë vit atëherë mbeten suficit, prandaj konsideroj se ri-alokimi i mjeteve është një e mirë për Komunën sepse i shmangemi suficitit dhe obligimeve për vitin e ardhshëm.

Pas votimit u konstatua se me 19 vota për, 12 vota kundër dhe 3 vota të përmbajtura, u miratua Propozimi i vendimit për ri-alokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2015

3. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë informatë dhe njëzëri i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim, dokument i cili nuk ka nevojë t'iu nënshtrohet procedurave të votimit, por është vetëm një informatë për këshilltarët e Kuvendit.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera shtoi, informata është përgatitur në bazë të kërkesës së Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrije-shirjet, planifikimet e të mbjellave pranverore dhe vjeshtore, dhe me theks të veçantë subvencionet në sektorin e bujqësisë që përfshihen, ndarja e serrave, subvencionimi me fidane të mjedrave dhe subvencionimi me shoqëri të bletëve. Sigurisht se jemi të vetëdijshëm se numri i aplikuesve ka qenë shumë i madh, shembull, nëse për shoqëri të bletëve aplikojnë 330 persona kurse përfitues janë 100 persona, është krejtësisht e natyrshme që 230 persona të jenë të pakënaqur. Vlen të ceket se për projektet e kësaj Drejtorie janë mbajtur trajnime shtesë në bashkëpunim dhe koordinim me shoqatat përkatëse të cilat operojnë në Komunën e Podujevës të cilat kanë ndikuar shumë si në aspektin e hartimit të kriterëve ashtu edhe në zbatimin e tyre. Gjithashtu vlen të ceket se, sa unë i kam parë përsëafërmi, Komisioni përkatës ka bërë një punë transparente dhe një punë të mirë sa i përket vlerësimit të dokumentacioneve përkatëse dhe përzgjedhjes së përfituesve të subvencioneve përkatëse. Nuk kam diçka më shumë të shtoj në këtë fjalë hyrëse, sepse të gjitha i kemi paraqitur në informatë, mirëpo jam i hapur për çdo sqarim, pyetje dhe përgjigje nga ana juaj.

z.Fidan Rekalju, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e vlerësojmë këtë informatë si të dobishme dhe mirë të përgatitur, dhe kërkojmë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që vazhdimisht të përkrahën qytetarët e Komunës së Podujevës në fushën e bujqësisë duke qenë në dijeni se kjo fushë, mund të them, tani ka filluar të jetë një ndër shtyllat më të rëndësishme të zvogëlimit të papunësisë dhe zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës. Pra edhe njëherë kërkojmë që vazhdimisht të përkrahën me subvencione qytetarët e Komunës së Podujevës nga ana e Komunës por pse jo duke kërkuar dhe duke gjetur mundësi edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar për këtë informatë dhe ia kam thënë drejtorit të Drejtorisë përkatëse se, besoj se ke më shumë aftësi për përgatitje të një informate më të mirë, andaj besoj se edhe vetë drejtori përkatës e din se nuk është një informatë ashtu siç duhet të jetë nga një Drejtori, ngase në këtë informatë janë paraqitur vetëm kushtet e aplikimit të cilat kanë

qenë edhe publike përmes ueb-faqes zyrtare të Komunës, si dhe janë paraqitur kriteret e përfitimit të donacionit e që mendoj se të gjithë aplikuesit që kanë dorëzuar aplikacionin kanë arritur të plotësojnë këtë performancë. Çështja tjetër është se kërkesë e Grupeve të këshilltarëve nuk ka qenë të informohemi se sa ka qenë numri i kombajnave që kanë marrë pjesë në korrje-shirje dhe cilat kanë qenë rendimentet e grurit, por ka qenë kërkesë për subvencionimet e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural karshi bujqve dhe agronomëve të Llapit, informatë e cila nuk është bërë. Unë e posedoj një dokument zyrtarë ku anëtarë të Komisionit për ndarjen e koshereve të bletëve kanë qenë z.Sabit Syla dhe z.Sabedin Namani dhe një anëtarë tjetër, komision për të cilin në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar vendimin e ngritjes së këtij komisioni dhe kërkoj prapë që në përfundim të kësaj mbledhjeje të na jepet nga një kopje të atij vendimi. I nderuari drejtor unë mendoj se është dashur të kontrollohet puna e komisionit të ngritur nga ju apo Kryetari i Komunës sa i përket ndarjes së subvencioneve, e them këtë duke u bazuar edhe në një dokument zyrtar të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i cili është nxjerrë pas kërkesave që kanë bërë disa media, sipas të cilit ndarja e koshereve të bletëve për 100 persona u janë ndarë 70% nga dy herë të njëjtëve persona, sikurse që kemi rast ku një vit i është dhënë burrit kurse në tjetrin vit gruas së tij, e që mendoj se nuk është e hijshme kjo, mirëpo janë bërë eliminime politike, eliminime të cilat nuk janë të mira i nderuari drejtor, dhe në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së për mbledhjen e radhës kërkoj nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural, raport për subvencionet e ndara, e jo raport për dokumentacionet që duhet të ketë një bujk ose agronom, e paraqita këtë kërkesë sepse mendoj se është shumë absurde që të ofrohet këshilltarëve dhe të diskutohet në Kuvend për një pikë të rendit të ditës që ka të bëjë me një informatë për kushtet dhe kriteret për aplikim për koshere të bletëve ose të serrave, ngase interesimi jon ka qenë, kostoja buxhetore e financimit për të mbjellura, sa ka qenë për korrje-shirje, kush kanë qenë aplikuesit që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret, listën e përfituesve dhe arsytimi për të eliminuarit, dhe kjo është kërkesa jonë, nuk jemi kundër atyre që kanë përfituar me koshere të bletëve apo subvencione tjera, mirëpo në çfarë mënyre iu janë dhënë ato subvencione nga komisioni përkatës, unë mendoj se edhe Kryetari i Komunës do të shqyrtoj pozicionin e dy Drejtorive, asaj për zhvillim ekonomik dhe asaj të Bujqësisë. Po ashtu drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me Kryetarin e Komunës e kanë refuzuar edhe një projekt të zhvillimit ekonomik, për sjelljen së lopëve nga Komisioni European me të cilët ju drejtor keni zhvilluar dy takime kurse Kryetari i Komunës nuk i ka pritur në takim fare, dhe projekti ka qenë që të sjellën lopë dhe t'i u dhurohen familjeve ne gjendje të rëndë sociale-ekonomike, dhe krejt kjo është bërë ngase se nuk keni pasur qasje i nderuari drejtor, dhe decidivisht Kryetari ka thënë, se unë duhet të takohem me atë person, por biznesmenët dhe donatorët nuk lidhen politikisht me paranë e tyre, andaj mendoj se është shumë gjë e keqe të udhëheqëni Drejtorinë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik dhe të qitni kushte për donatorë dhe investitor të ndryshëm në Llap, aq më keq të autorizoheni për udhëheqje edhe me një Drejtor tjetër dhe të sjellësh një informatë të tillë të cilën e kemi paravetës tani, kështu që kërkesë e Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së për mbledhjen e radhës është që, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të sjellë një raport për subvencionimet duke bashkëngjitur listën e përfituesve, listën me një arsytim për ata që nuk kanë përfituar, dhe shqyrtimin e komisionit për

subvencionim të dyfishtë për një familje, kërkesë e cila do të bëhet në çdo mbledhje nëse nuk sjellët në mbledhjen e radhës.

z.Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kemi kërkuar disa herë të debatojmë për Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural mirëpo kjo nuk ka ndodhur deri më tani, por edhe pse me vonesë, sot e kemi një informatë nga kjo Drejtori të cilën e përshëndesim dhe kërkojmë të kemi informata të tilla edhe nga Drejtoritë tjera sepse vetëm në këtë mënyrë mundë të ngritët llogaridhënia dhe transparenca që është synim i LVV-së dhe subjekteve tjera besoj. Edhe pse informata është jo e plotë dhe nuk preken problemet e fermerëve dhe nuk ka vizion për të ardhmen megjithatë këshilltarët e Kuvendit kanë disa informata. Vërejtja jonë është se në këtë informatë fare nuk preket pylltaria respektivisht gjendja e ekosistemit pyjorë dhe pyllëzimet për të cilat nuk jemi në dijeni se a kemi ndonjë projekt, vërejtja tjetër që ne kemi ka të bëjë edhe me subvencionet e ndara nga kjo Drejtori ku ka persona të cilët marrin disa herë subvencione, dhe kjo çështje është mirë të merret parasysh nga ana e kësaj Drejtorie. Në bazë të shënimeve që kemi rreth 66% e popullatës së Kosovës jetojnë në zonat rurale dhe përafërsisht e njëjta gjendje qëndron edhe në Komunën e Podujevës, prandaj për ne Lëvizjen Vetëvendosje zhvillimi i këtij sektori për të cilin jemi duke debatuar sot ndikon dukshëm në rritjen ekonomike dhe arritjen e mirëqenies së qytetarëve. Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje konsideron se Podujeva ka nevojë për një strategji qeveritare afatgjate lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe pylltarisë duke filluar nga planifikimi i buxhetit, investimet kapitale, subvencionet, grantet, fondi i dedikuar për zhvillimin e bujqësisë, numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë, në agrobiznes, agropunësim, në sektorin e pylltarisë, turizmit, zëvendësimi i importit me prodhime vendore e të tjera. Gjatë vizitave dhe bashkëbisedimeve me fermer na është thënë se fermerët ballafaqohen me vështirësi të mëdha të cilat do t'i paraqesë në vazhdim; konkurrenca nga prodhimet e importuara në tregun vendorë, vështirësi për tu plasuar prodhimet jashtë vendit, mekanizmi i bujqësisë i vjetruar, mungesa e këshilltarëve të mjaftueshëm për fusha të caktuara, cilësia e dobët e farës dhe plehrave të importuara, mungesa e pikave dhe objekteve grumbulluese për prodhimet vendore, mungesa e fabrikave për përpunimin e produkteve të pemëve, perimeve e të tjerave, pra përfundimisht qeveria komunale nuk ka strategji për të prodhuar dhe mbrojtur produktet vendore e që një pjesë e madhe e popullatës mbijetojnë nga ky sektor. Meqenëse bujqësia edhe punëson por edhe prodhon, hartimi i një strategjie për zhvillimin e bujqësisë sipas LVV-së duhet të jetë prioritet i qeveris komunale. Në vazhdim do të paraqesë disa propozime të Grupit të këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LVV-së drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe në përgjithësi qeverisë komunale, dhe atë; 1-investimi në infrastrukturë për mbështetjen e aktiviteteve bujqësore, 2-investimi në ngritjen e një qumështoreje për përpunimin e qumështit ditorë, 3-ndërtimi i depove për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimeve, 4-shtimi i fondit blegtoral, 5-shfrytëzimi racional i pyjeve dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të reja, 6-pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe rregullimi i sistemit për ujitje të sipërfaqeve bujqësore e posaçërisht atyre që shtrihen përgjatë lumit Llap, 7-ngritja e mini-fermave në fshatra, 8-ngritje profesionale për fermer dhe mbështetje e mini-fermave, 9-ndarje e subvencioneve të bëra me kritere dhe jo me anime politike. Pra edhe njëherë e përsërisë, ne e përshëndesim ndarjen e subvencioneve por megjithatë e kundërshtojmë mënyrën e ndarjes në baza dhe me anime politike ashtu siç po bëhet, andaj duke u nisur nga të gjitha këto ne mendojmë se

Komuna duhet të ndërtoj dhe të ketë vizionin e vetë për bujqësinë dhe zhvillimin rural duke u bazuar në resurset e veta bujqësore dhe konfiguracionin gjeografik në mënyrë që të inkurajoj fermerët për të investuar në bujqësi e ku do të ndikonte edhe në punësimet e reja në këtë Komunë.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, zakonisht rreth informatave nuk debatohet edhe shumë, andaj unë nuk e kam ndërmend të debatoj meqë Drejtoria përkatëse ka paraqitur një informatë të tillë, mirëpo e mbështesë fuqishëm atë që z.Rafet Llapashtica e tha se në një mbledhje të ardhshme të jetë një raport ku ne do të debatonim rreth gjendjes në sektorin e bujqësisë. E falënderoj drejtorin e Drejtorisë përkatëse për përpjekjet për informatën që e ka bërë, për kundër që unë konsideroj se nëse lexohet kjo informatë, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk do të kishte nevojë të kishte më shumë se një të punësuar, sepse këto që na janë prezantuar në këtë informatë janë vetëm çështje teknike. T'ju them të vërtetën unë sinqerisht kam pritur që do të përfshihen; sa është gjendja aktualisht e pyjeve sepse afërsisht gjysma e territorit të Komunës së Podujevës është me pyje, në raport me 22000 hektar në sektorin publik dhe 7000 në sektorin privat, pastaj cila është gjendja e tyre, çka planifikohet në atë drejtim jo vetëm me ruajtjen e tyre por edhe me ndërrimin e strukturës pyjore, çështja tjetër, çka është duke ndodhur me drutë të cilat konfiskohen për çdo ditë nga prerësit ilegal, dru të cilat deponohen mirëpo ku po mbesin pastaj, pastaj kam pritur që do të informohemi për gjendjen e lumenjve në Komunën e Podujevës, kam pritur të informohemi se cili është aktiviteti i inxhinierëve të Drejtorisë dhe këshillimeve profesionale me fermerët e Komunës dhe në cilat kohë e që zakonisht është koha e pushimeve gjegjësisht koha e dimrit përdoret për këtë punë, dhe në fund më lejoni që në formë të pyetjes t'ju nxisë që herën tjetër në raport të na prezantoni metodën krahasuese, sa është kostoja, ta zëmë për 1000 shoqëri bletë, dhe sa është e pritshme ajo kosto që të ketë gjenerim të të ardhurave dhe vende pune, dhe me të njëjtën vlerë sa është e pritshme gjenerimi i mjeteve dhe vendeve të punës ta zëmë, nëse me aq mjete subvencionohen me mjedra, boronicë, arrë, lajthi, bimë mjekuese apo të tjera. Pra vetëm ndarja dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore për subvencione nuk mjafton. Po ashtu e mbështesë fuqishëm deklarin e shefit të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së z.Fidan Rekaliu, mirëpo më hamend paksa ndërrimi i qëndrimit nga ana e tij sepse para kësaj mbledhjeje kur debatonim për miratimin e projektbuxhetit të Komunës për vitin e ardhshëm dhe ne bënim vërejtje dhe insistonim të mos zvogëlohet buxheti për subvencione por ai të rritet, këshilltari i cekur hapur e mbështeti zvogëlimin e tij, e që këto të dyja bashkë nuk shkojnë.

Kosova aktualisht e ka rreth 5 miliard brutoproduktin, sektori i agrarit gjithsesi se e dyfishon këtë nëse trajtohet si temë komerciale dhe profitabile, jo siç jeni duke e trajtuar si tradicionale, prandaj i nderuari drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me shumë kënaqësi do të debatoja në një mbledhje të ardhshme rreth agrarit sepse fuqishëm besoj se është një prej degëve më strategjike për zhvillimin e Komunës.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, theksoi, fillimisht i falënderoj këshilltarët parafolës z.Rafet Llapashtica dhe z.Lutfi Rexhepi për konstatimin e tyre sipas të cilëve unë kam kapacitet më të madh për hartimin e një informate apo raporti më të zgjeruar, mirëpo ne e kemi parë të arsyeshme dhe jemi koncentruar në pikat përkatëse në bazë të kërkesave që ju i keni bërë, në të kundërtën ne do të mund të hartonim raport më të zgjeruar. Po ashtu ne i konsiderojmë me vëmendje të lartë edhe rekomandimet e Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së edhe përkundër

asaj që kërkesë e tyre nuk kanë qenë pyllëzimet dhe pikat tjera të cilat u potencuan nga përfaqësuesi i këtij subjekti. Sa i përket çështjeve të ngritura nga z.Rafet Llapashtica, ne si Drejtori nuk kemi shërbime informative për ato çështje të cilat i potencoi ai apo thënë ndryshe ne nuk jemi në dijeni për atë investitor që ai e përmendi për sektorin e blegtorisë, por nëse keni ndonjë investitor të gatshëm, është në interesin e juaj si qytetarë por edhe në interesin e Komunës dhe do të ishte mirë të koordinohemi, andaj me përgjegjësi e them se te unë si drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka qenë askush të bisedoj në lidhje me atë çfarë këshilltari i cekur e potencoi, dhe nëse këshilltari i cekur e din lirshëm mund të del në foltore dhe t'i thotë emrat e atyre. Përndryshe kërkesat të cilat u ngritën nga parafolësit unë më shumë i konsideroj si konsum politik sepse ato kërkesa nuk ka qenë të definuara, por ka qenë kërkesë për një informatë rreth korrije-shirjeve, planifikimit dhe subvencioneve, ashtu sikurse që nuk ka qenë kërkesë për specifikime me emra për ata që kanë qenë përfitues dhe atyre që nuk kanë qenë përfitues. Pra kriteret janë shumë të qarta dhe arsyeja e refuzimit të atyre që nuk kanë përfituar është vetëm mos plotësim i kriterëve, ndërsa sa i përket çështjeve që ju i përmendët dhe që po thirreni në bazë të disa portaleve informative, ju sugjeroj t'i lexoni titujt me shumë vëmendje, sepse aty bëhet fjalë për koshere dhe pogaçe të bletëve që janë ndarë nga Komuna e Podujevës në bazë të informatave që i kam sepse unë jam emëruar drejtor në vitin 2014, andaj nuk qëndron ajo siç ju e keni polemizuar rastin e z.Ilmi Sylës nëpër portale të cilave ju i rrini mbrapa, e them këtë ngase personi i cekur ka qenë përfitues nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e cila ka qenë e udhëhequr nga një ministër nga radhët e subjektit t'juaj dhe nëse ai person ka qenë përfitues, ka qenë përfitues i makinerive por jo i bletëve madje pikërisht nga Ministria e udhëhequr nga ju, dhe me plotë përgjegjësi ju them se ai person është subvencionuar me bletë për herë të parë nga Komuna e Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, drejtori parafolës më detyroi të replikoj sepse ai e ceku se nuk jemi takuar asnjëherë me atë investitor, unë e them se jeni takuar dy herë në zyrën tënde dhe i keni thënë investitorit se do t'juja caktoj një takim me Kryetarin e Komunës, pastaj Kryetari ju ka thënë juve se po ju pres në zyrë, por pastaj ka thënë se sot nuk kam kohë, mirëpo për këtë çështje nuk dëshiroj të hyjmë më në detaje. Ju i përmendët mediat, dhe tani unë dëshiroj të ngrisë një çështje, në muajin dhjetor 2014 nga vetë zëdhënësi i Komunës është thënë se disa fshatra kanë grumbulluar rreth 70,000.00€ për ujësjellësin e Revuçit dhe ende ato para ruhen. Sa i përket informatës, unë nuk dëshiroj të gjykoj, por vetëm e thash se ju si drejtor keni aftësi të hartoni një dokument më profesional dhe ende mendoj ashtu, por e di edhe pse është ofruar kjo informatë në një gjendje të tillë. Nëse Kuvendi kërkon raport për subvencionimet dhe nëse është një qeverisje transparente, i nderuari drejtor është dashur që në fillim t'iu velen kushtet e eliminimit, e them këtë ngase ata të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin në bazë të kërkesës tuaj ata persona i kanë plotësuar kushtet ngase në të kundërtën nuk do të mund të aplikonin, por nëse u janë pranuar aplikacionet pa plotësim të kushteve atëherë është defekt i juaj.

Prandaj të jemi të sinqertë, as Kryetari i Komunës, as drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave nuk mund të jap përgjigje konkrete, pse u janë marrë atyre banorëve të disa fshatrave rreth 70,000.00€ për ujësjellësin e Revuçit, dhe ende nuk ka ujë në ato fshatra, ku janë ato mjete, në ndonjë bankë apo në xhep të ndokujt, nuk po supozoj në askënd, janë në buxhet të Komunës apo çka është punuar me ato mjete që u janë marrë atyre banorëve që disa vite dhe projekti për Vrellën e Revuçit nuk ka mundur të realizohet për

shkak të terrenit që fshatarët nuk kanë lejuar, dhe për këtë nuk mund të jap përgjigje askush sikurse që nuk mund të jap përgjigje as drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural rreth përzgjedhjes së 30 përfituesve të koshereve të bletëve, pra ne kërkojmë përgjigje konkrete rreth, mjeteve të parapara, përfituesve sipas kushteve dhe arsytim për të eliminuarit, mirëpo drejtori ka pranuar 300 aplikacione, janë përzgjedhur 100 përfitues dhe ka dal lista e përfituesve dhe pastaj është hequr ajo listë e që nuk është dashur të ndodh, por është dashur të jepet një arsytim për të eliminuarit. Sa i përket përzgjedhjes së përfituesve mendoj se komisioni përkatës është dashur të hartoj pikë dhe me pikë të bëjë përzgjedhjen sikurse që e ka bërë komisioni për ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së buxhetit dhe Financave, theksoi, dëshiroj të jap një informatë rreth mjeteve të grumbulluara nga qytetarët e fshatrave përkatëse për projektin e Vrellës së Revuçit, ato mjete nga viti 2006-2007 ruhen në buxhetin e Komunës së Podujevës, përkatësisht në llogarinë e vetme në thesarin e Ministrisë së Financave, qëndrojnë në atë llogari derisa të mos vendoset ndryshe nga ana e qytetarëve dhe nuk mund të shfrytëzohen nga askush. Vlen të ceket se në çdo raport financiar që paraqitet para jush ajo pjesë e mjeteve pasqyrohet si participim i qytetarëve gjegjësisht donator të brendshëm.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj të plotësoj drejtorin parafolës meqë në kohën kur është bërë participimi nga komuniteti për projektin e Vrellës së Revuçit, kam qenë pjesë e Ekzekutiviti të Komunës, projekt i cili është hartuar nga një kompani dhe i cili është financuar nga IOM, organizatë e cila ka ndarë 200,000.00€, dhe komuniteti i gjashtë fshatrave e kanë mirëpritur këtë dhe me gjithë dëshirë kanë marrë pjesë me participim në këtë projekt, mirëpo pengesë e vetme e mos realizimit të projektit është komuniteti përreth që jetojnë të cilët nuk kanë dhënë pëlqim dhe kanë penguar realizimin e atij projekti, përndryshe i lusë të gjithë këshilltarët e Kuvendit nëse kanë ndikim, të angazhohen në realizimin e atij projekti sepse Komuna e Podujevës besoj se është e gatshme të filloj me financim, në të kundërtën ato mjete duhet t'iu kthehen komunitetit kur do që komuniteti bënë një kërkesë të tillë, mirëpo konsideroj se realizimi i atij projekti do të ishte në interes të madh për ato fshatra.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, unë e falënderoj shumë drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për këtë informatë, dhe besoj se edhe në të ardhmen do të kemi informata të tilla.

4. Të ndryshme

znj.Kumrie Hoti, theksoi, gjatë vizitave të bëra Shoqatave të dala nga lufta në Komunën e Podujevës, nga shqetësimet e shumta që u prezantuan, është një nga to për të cilën do të dëshiroja të diskutoja me ju koleg të nderuar. Çështja ka të bëjë me vazhdimin e shtëpive për familjet në nevojë në Lagjen e Dëshmorëve. Nga informatat që kam, Komuna e Podujevës është dashur të përgatit planin për numrin e shtëpive të reja që do të ndërtohen. Në takimin e fundit të komisionit përkatës ishte diskutuar shqyrtimi i mundësisë që shtëpitë e tjera që do të ndërtohen të kenë sipërfaqe më të madhe të banimit. Pyetje, a do të fillohet të ndërtohen shtëpit dhe sa është numri i atyre që do të

ndërtohen, duke pasë parasysh se ka një Memorandum Mirëkuptimi mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Çështje tjetër të cilën dëshiroj të diskutoj ka të bëjë me një shqetësim shumë të madh ku banorët e fshatit Surdull sipas informatave të tyre të cilët kanë shpreh vullnet dhe më janë drejtuar mua si këshilltare e Kuvendit, kanë shpreh një breng ku fëmijët e tyre që pesë javë, nga 10.09.2015, nuk janë duke vijuar mësimin për shkak se nuk kanë transport për bartjen e atyre nxënësve shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, dhe sipas informatave që kam nga ata banorë rruga nga fshati Surdull deri te shkolla e fshatit Herticë është më pak se 8 km në një drejtim dhe sipas tyre Komuna është në dijeni për këtë problem, dhe unë mendoj se është shqetësim mjaft i madh. Jam në dijeni se Komuna e Podujevës ka marrë disa hapa dhe e ka shpall tenderin për operatorët ekonomik që dëshirojnë të kryejnë atë shërbim, mirëpo tenderi është anuluar për shkak të mospërmbushjes së kriterëve tenderuese, do të thotë kanë qenë vetëm dy ofertues, andaj unë mendoj dhe jemi shumë të vetëdijshëm se duhet të respektohen kriteret mirëpo në të njëjtën kohë duhet të kemi parasysh edhe humbjet që ju shkaktohen nxënësve nga mosvijueshmëria në mësim, dhe pyetja është, a ka mundësi që Komuna të bëjë ndonjë zgjidhje alternative për ata nxënës derisa të kryhen procedurat e tenderimit, dhe shpresoj të gjendet një zgjidhje për ata nxënës ose të paktën drejtori i Drejtorisë së Arsimit të na jap një sqarim rreth kësaj çështjeje, sepse edhe ata fëmijë janë pjesë e kësaj Komune.

znj.Florije Maliqi, theksoi, dëshiroj të ngreh një shqetësim të banorëve të Lagjes së Dëshmorëve lidhur me rastin e mbetjes pa energji elektrike të asaj lagjeje prej më shumë se një javë. Cili është reagimi juaj ndaj asaj kategorie të qytetarëve dhe ku janë përpjekjet e juaja për të negociuar me KEDS. Vlen të ceket se nuk duhet harruar fakti që ky Kuvend në të kaluarën ka marrë vendime unanime që kësaj kompanie iu janë dhënë prona në shfrytëzim afatgjatë pa pagesë-kompensim. Andaj mendoj se ajo kategori meriton trajtim më të dinjiteteshëm.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, dëshiroj të bëjë një pyetje, pse po mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të kaluara, si dhe ku janë përgjigjet e pyetjeve të bëra në seancën e kaluar, ku këto përgjigje iu interesojnë edhe votuesve të juaj pasi që ata drejtohen tek zyret tona të Lëvizjes Vetëvendosje që janë të zhgënjyer nga premtimet e bëra dhe të parealizuara, kështu që pres përgjigje në seancën e ardhshme.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, sa i përket ekstrakteve të procesverbaleve të dy mbledhjeve paraprake, ato nuk kanë të gatshme për këtë mbledhje por shpresoj se në mbledhjen e radhës do të jenë të gatshëm për shqyrtim.

Me që nuk pati këshilltarë të tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 12;20

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-006-92636
Podujevë,
20 tetor 2015

Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi